REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 874/20
Datë/Datum. 11.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi ***Dior Halili***	***Data e autorizimit të ekspertit*** ***02/11/2020***	*Data e dorëzimit të raportit* ***11/11/2020***

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 30.10.2020, **OE "Infinit SH.P.K" – Prishtinë**, ka parashtruar ankesë me **nr: 874/20** kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit numër **"62500-20-5915-1-2-1"**, respektivisht atij me titull **"FURNIZIM ME MJETE KONKRETIZIMI - PAISJE PËR KABINET TË SHKOLLAVE FILLORE DHE TË MESME TË KOMUNËS SË MALISHEVËS"**, iniciuar nga AK – **KK Malishevë.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizime, ndarja në pjesë: jo, vlera e parashikuar e kontratës: 80,330.50€.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim.

Njoftimi për kontratë: 01.10.2020.
Afati i fundit për dorzimin e ofertav: 12.10.2020.
Dta dhe ora e hapjes se ofertav: 12.10.2020. ora 14:30
Njoftimi mbi vendimin e AK: 15.10.2020.
Kriter per dhenie te kontrates: Tenderi i pergjegjshem me cmimin me te ulet

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2.PRETENDIMET ANKIMORE

Me datën: 30.10.2020, **OE "Infinit SH.P.K" – Prishtinë**, ka parashtruar ankesë me **nr: 874/20** kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit numër **"62500-20-5915-1-2-1"**, respektivisht atij me titull **"FURNIZIM ME MJETE KONKRETIZIMI - PAISJE PËR KABINET TË SHKOLLAVE FILLORE DHE TË MESME TË KOMUNËS SË MALISHEVËS"**, iniciuar nga AK – **KK Malishevë.**

OE ankues ka pretenduar që janë shkelur këto dispozita ligjore:

Neni 1- Qellimi
Neni 6- Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
Neni 59- Ekzaminimi, vleresimi dhe krahasimi I tendereve
Neni 60- Kriteret per dhenie te kontrates
Neni 72- Dokumentacioni dhe informacioni shtesë
Neni 39 i UOPP-se Sqarimi i tendereve
Neni 41 i UOPP-se Ekzaminimi, veresimi dhe krahasimi i tendereve

AK/Komisioni vlersues gjatë vlerësimit të ofertave për projektin në fjalë nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 përkatësisht dispozitat ligjore të lartëcekura dhe Udhëzimin operativ për prokurim publik.

AK/zyra e prokurimit me 12.10. ka nxjere njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe letrat standarde per OE ofertues, kompania jone eshte eliminuar me arsyetimin:

Ju eliminoheni per arsyeje se- ju mungojne deshmite se keni perfunduar me sukses kontrata te natyres se njejte ne tri vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit per kontrate te realizuara minimumi ne vere prej 80,000.00euro. Ne baze te nenit 72 dhe 59 te LPP-se Lista e kontratave te realizuara e dorezuar nuk permbush kerkesat minimale te vleres se percaktuar nga AK. Refuzohet tenderi pa kerkuar informata te metutjeshme.

Konstatimi i AK/komisionit vleresues eshte i paqendrueshem dhe jo-ligjor,kompania jone ka dorezuar listen e projekteve te realizuara ne 3vitet e fundit/ listen gjenerale ku jane te paraqitura dhjetera projekte te natyres se njejte me kete aktivitet te prokurimit.

Nga lista e kontratave e dorezuar ne kete projekt, kontratat me nr rendor ne liste: 2, 8, 24, 29, 30, 31, 36, 38, 39, 40, 50, 52, 53, 54, 62, 64, 75

Jane kontrata te natyres se njejte me kete aktivitet te prokurimit dhe nese nxjerim totalin e tyre arrin vleren 1,160.039,[82]€. Furnizime te realizuara ne 3 vitet e fundit para publikimit te njoftimit per kontrate per kete projekt.

AK duke u thirur ne nenin 72.3 te LPP-se dhe nenin 39 te UOPP-se ka mundur te kerkoje sqarime shtese lidhur me kontratat e natyres se njejte te cekura ne liste.

Citoj nenin 72.3 te LPP-se:

-Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për **dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve**, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

AK para se te vendos per eliminimin e kompanise sone eshte dashur te veproj konform LPP dhe UOPP duke u thirur ne dispozitat ligjore te lartecekura te kerkoje sqarime shtese nga kompania jone per kontratat e natyres se njejte te cekura ne liste.
Bashkangjitur me kerkese per ri-shqyrtim i kemi dorezuar AK deshmite per realizimin e kontratave te cekura ne liste mirepo AK nuk i ka mar parasysh dhe nuk ka ri-vleresuar aktivitetin e prokurimit.

Si pasoje e shkeljeve te lartecekura nga AK/komisioni vleresues ka ardhe deri te eliminimi i kompanise sone pa te drejte dhe njekohesisht na eshte pamundesuar fitimi i nje kontrate publike.
Kompanise sone i eshte mohuar nje fitim simbolik i paramenduar nga kjo kontrate dhe eshte demtuar buxheti i shtetit perkatesisht KK Malisheve per 3436.50euro.
Kerkojme nga organi shqyrtues i prokurimit qe te aprovoje ankesen e kompanise sone si te bazuar, lenda te kthehet ne ri-vleresim dhe konform nenit 72.3 te LPP-se dhe nenit 39 te UOPP-se AK te kerkoje sqarime shtese te datajishme lidhur me kontratat e cekura ne liste.
Kerkojme qe ankesa te aprovohet si e bazuar.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

Fakt 1: *Kapaciteti teknik dhe profesional, respektivisht kërkesa 2.4 sa i përket dëshmive dokumentare të kontratave të natyrës së njejtë.*

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës se njëjtë në tri vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit për kontratë të realizuara minimumi në vlerë prej; 80,000.00 Euro.	**a)Një Listë e Furnizimeve të natyrës se njëjtë të realizuara në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë duke saktësuar Furnizimet e kryera, shumën e kontratës vendin, datën si dhe nr e prokurimit, kjo listë duhet te jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga kompania (origjinal), po ashtu duke i bashkangjitur referencat të njëjta ose raportet e pranimit.**

Fakt 2: *Shënim për evidencën dokumentare e paraqitur në RRUOPP – faqe 66*

- Nëse për ndonjë arsye valide, operatori ekonomik nuk është në gjendje të sigurojë referencat e kërkuara nga autoriteti kontraktues në pajtim me nenet 69 të LPP-së, operatori ekonomik në fjalë mund të lejohet që të tregojnë ***aftësitë teknike dhe / ose profesionale*** përmes ndonjë dokumenti tjetër që autoriteti kontraktues, duke siguruar konkurrencën dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomik, i konsideron të përshtatshme. Në mënyrë alternative autoriteti kontraktues mund të kërkojë listat e referencave të projekteve dhe detajet nga personi kontaktues dhe t`i verifikojë referencat nëse e gjykon të arsyeshme. Sipas kërkesës se një operatori ekonomik për t'iu lejuar për të përdorur dokumentacionin alternativ siç është përmendur në këtë pjesë, autoriteti kontraktues duhet ti jap kohën e mjaftueshme operatorit ekonomik për dokumentacionin e përmendur. Afati kohorë i tillë nuk mund të jetë më pak se pesë (5) ditë.

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:
N/A

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Pas shqyrtimit në detaje të lëndës së tenderit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe duke u bazuar në dokumentacionin në dispozicion, eksperti shqyrtues jep këtë mendim si në vijim:

Sa i përket pretendimit ankimor ku thuhet që OE ankues është eliminuar nga AK për arsye që i mungojnë dëshmitë dokumentare të kontratave referencë të natyrës së njëjtë apo të ngjashme per 3 vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë të realizuara, minimumi në vlerë prej 80,000 EUR, Eksperti pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe shkresave të dorëzuara e gjen pretendimin si pjesërisht të pabazuar. Arsyetimi i një konstatimi të tillë vijon si më tutje:

- Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 68 të LPP-së dhe në kundërshtim me nenin 39.8 të RRUOPP, gjegjësisht tek shembujt ku jepen në detaje problemet dhe hapat e mëtutjeshëm të veprimit konform dispozitave ligjore. Në rast të mungesës së referencave/certifikatave të pranimit nga lista e kontratave të prezantuara, Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë informata sqaruese konform nenit 69.
- Duhet pasur parasysh që nëse për ndonjë arsye të vlefshme, operatori ekonomik nuk është në gjendje të sigurojë referencat e kërkuara nga autoriteti kontraktues, operatorit ekonomik i lejohet që të demonstrojë gjendjen e vetë ekonomike dhe financiare përmes dokumentit tjetër që autoriteti kontraktues, në ushtrimin e diskrecionit të tij të arsyeshëm, e konsideron të përshtatshëm.
- Për faktin që lista e kontratave përfshin gjithsej 81 kontrata të cilat janë të shënuara nga OE ankues si referencë e që kanë natyrë të ngjajshme apo të njejtë me aktivitetin e tanishëm të prokurimit, mbetet nën përgjegjësinë juridike të Autoritetit Kontraktues që të konstatojë nese përmbajtja (artikujt në rast të furnizimit) e tyre përkon me fushëveprimin e këtij aktiviteti të prokurimit.
- Po ashtu, konform dispozitave ligjore, **periudha e vlefshmërisë e kontratave si referencë merret duke pasur parasysh vetëm datën e përfundimit të kontratës**. Një gjë e tillë mund të shihet edhe në RRUOPP, tek pjesa e "Shënim për kërkesat e aftesise teknike dhe/ose profesionale (neni 69 i LPP-se):", gjegjësisht pjesa: *"Në të gjitha rastet e përfshira në 2.1, 4.2 dhe 6.2 të nenit 69 te LPP-se përmendet shprehja si në vijim citojmë: ".....të realizuara (përfunduara) në tri vitet e shkuara "ose "...në periudhën e shkuar trevjeçare... "). Në kuptimin e Ligjit shprehja "tri vitet e shkuara" nënkupton: Periudhën kohore te përcaktuar në këto nene e cila ndërlidhet me periudhën qe paraprin datën e publikimit të njoftimit për kontratë ose, në rast të procedurave të negociuara pa publikimin e njoftimit te kontratës, dërgimin e ftesës për pjesëmarrje ose tenderim"*
- Një interpretim është dhënë decitivisht edhe nga KRPP, duke theksuar që *"nëse gjatë një aktiviteti të prokurimit, një Autoritet Kontraktues në dosje të tenderit ka vendosur kërkesën që Operatorët Ekonomik*

të kenë kontrata të realizuara në 3 vitet e fundit (nga data e njoftimit për kontratë), kjo do të thotë që kontratat e kërkuara nga AK, duhet të jenë të realizuara (jo në realizim e sipër) pra të përfunduara brenda tri viteve të shkuara nga data e njoftimit për kontratë, ku për bazë merret data e përfundimit dhe jo e fillimit të kontratës".

Duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, kronologjinë e rastit në fjalë dhe natyrën e pretendimeve, Eksperti shqyrtues e sheh ankesën e operatorit ekonomik ankues si pjesërisht të bazuar, duke sugjeruar kështu që njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "FURNIZIM ME MJETE KONKRETIZIMI - PAISJE PËR KABINET TË SHKOLLAVE FILLORE DHE TË MESME TË KOMUNËS SË MALISHEVËS" me nr. të prokurimit: "62500-20-5915-1-2-1", aktivitet ky i iniciuar nga AK: KK Malishevë, të anulohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Një sugjerim i tillë vjen si rezultat i konstatimeve të pretendimeve.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues duhet të jetë: pjesërisht e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues **KK Malishevë**
- Panelit Shqyrtues **OSHP**
- OE ankues **Infinit SH.P.K**